

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë për kategorinë “asistent lektor” për lëndët:

- *Ekonomia e Mjedisit;*
- *Simulimi Termik i Ndërtesave.*

Kandidati/a duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë diplomuar në degën "Inxhinieri Mjedisit", Master Shkencor, “*Profili Energjetikë*”, ose sistemi i integruar 5 vjeçar “*Profili Energjetikë*”, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës ose në Universitete të Huaja.
2. Nota mesatare të jetë ≥ 8.0 , për të gjitha ciklet e studimit universitar.
3. Aplikantët kandidatë duhet të kenë eksperiencë pune, si personel akademik pranë një Universiteti të njohur zyrtarisht nga MAS.
4. Preferohen kandidatë të cilët kanë eksperiencë në mësimdhënie për disiplinat e kërkuara (e dokumentuar me vërtetimet përkatëse nga Institucionet e angazhuara).
5. Të zotërojë një gjuhë të huaj, me dëshmi apo certifikatë, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, (preferohet anglisht).
6. Preferohen kandidatë të cilët kanë kryer kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit.
7. Preferohen kandidatë të cilët kanë angazhime dhe pjesmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.
8. Preferohen kandidatë të cilët kanë publikime të tjera në formë artikujsh në revista brenda dhe jashtë vendit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **21.10.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.